

13 mars 2026,
Prishtinë

Vendim i Bordit të FBK-së i datës 13.03.2026, Prishtinë

Shpallja e Ditës së Basketbollit në Kosovë

Në mbështetje të kompetencave të Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) që dalin nga Statuti, gjegjësisht neni 24, dhe duke marrë parasysh rëndësinë historike të datës **13 mars 2015**, kur Federata e Basketbollit të Kosovës u pranua si anëtare me të drejta të plota në FIBA, si dhe në përputhje me objektivat e **Planit Strategjik të FBK-së 2026–2030**, veçanërisht objektivin strategjik **“Zgjerimi i Komunitetit të Basketbollit”**,


Bordi i FBK-së, më 12.03.2026, vendos si më poshtë:

- 1. 13 marsi shpallet zyrtarisht si Dita e Basketbollit në Kosovë.**
- Kjo datë shënon pranimin e Federatës së Basketbollit të Kosovës si anëtare me të drejta të plota në FIBA dhe përfaqëson një moment historik për integrimin ndërkombëtar dhe zhvillimin e basketbollit në Republikën e Kosovës.
- FBK do ta shënojë këtë ditë çdo vit përmes aktiviteteve promovuese, sportive dhe edukative, me qëllim të:
 - forcimit të identitetit dhe traditës së basketbollit në Kosovë;
 - zgjerimit dhe përfshirjes së komunitetit të basketbollit;
 - promovimit të vlerave të sportit në nivel kombëtar.
- Aktivitetet për shënimin e kësaj dite do të organizohen nga FBK në bashkëpunim me klubet, shkollat, institucionet dhe partnerët e Federatës.
- Për vitin aktual, kjo ditë do të shënohet në mënyrë simbolike, ndërsa në vitet në vijim Federata do të zhvillojë dhe zgjerojë format e organizimit të aktiviteteve në kuadër të kësaj dite.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Në emër të Bordit të FBK-së,

Arben FETAHU



Federata e Basketbollit të Kosovës

